

Bazuar në nenin 8 të Ligjit Nr.03/L-212 të Punës , nenit 4 të UA 07/2017 për rregullimin e procedurave të konkursit në sektorin publik nenit 4 të Rregullores mbi Marrëdhënjen e Punës të punëtorëve të KRU “ Hidrodrini “ Sh. A. Pejë “KRU “ Hidrodrini “ Sh. A.- Pejë, publikon këtë :

## K O N K U R S

**Pozita :** Inxhinier/e për humbje te ujit

**Ekzekutues:** 1 (Një).

**Vendi :** Pejë

**Kohëzgjatja e Kontratës:** Kontrata lidhet për kohë të caktuar (6 mujore), me mundësi vazhdimi varësisht nga angazhimi i të punësuarit.

Nën mbikëqyerjen e Drejtorit Teknik dhe Kryeshefit Ekzekutiv

**Bashkëpunon me :**

- Drejtorin Teknik
- Të gjitha departamentet tjera

**Aftësitë dhe kompetencat kyçe :**

- Përvojë të deshmua në profesion dy vite ;
- Të jetë i çertifikuar për humbje te ujit , ose te ketë referenca te trajnimeve për humbje te ujit ;
- Aftësi të mira në komunikim dhe negocim ;
- Aftësi në menaxhimin e punës ekipore ;
- Aftësi në planifikim dhe konceptim;
- Njohja e gjuhes Angleze ;

**Detyrat dhe përgjegjësitë :**

- Të jetë i aftë që te punoj me orar të plotë 8 orë brenda 24 orëve dhe në rast nevojë edhe natën për shkak të specifikave të punës se detektimit;
- Analiza te humbjeve teknike ne zonën e furnizimit;
- Monitoron dhe raporton per DMA zona;
- Hartimi i planit për punët në teren në lidhje me detektimin e rrjetit te ujësjiellësit;
- Të përgatitë raporte ditore, javore, mujore dhe te njëjtat te raportohen tek vartësi i tij.
- Të bëjë detektim së bashku me ekipe në nivel të Kompanisë;

- Si udhëheqës i ekipeve te detektimit do te jete përgjegjës për mirëmbajtjen e pajisjeve te detektimit dhe te raportoje në aspektin e mirëmbajtjes;
- Sigurimi i kontrolles dhe leximi i gjendjes së ujëmatësve kryesor ne te gjitha DMA;
- Ushtron punen e kontrollimit të derdhjeve të ujit në tërë K.R.U. si dhe zbulimin e rrjedhave të ujit;
- Organizon me stafin punën e detektimit ne teren;
- Hartimi dhe zhvillimi i raporteve mujore dhe vjetore lidhur me leximet e orëmatësve kryesor dhe te burimeve;
- Sigurimi i informatës/dokumentit të duhur të ujëmatësve kryesor.
- Për punën e tij i përgjigjet Drejtorit Teknik.

**Kandidatët e interesuar duhet të plotësojnë aplikacionin për punësim dhe të njëjtit t'ia bashkangjitin këto dokumenta :**

- Diplomë e Universitare e Fakultetit të Inxhinierisë së Ndërtimit departamenti i Hidroteknikës ;
- Biografinë (CV) e detajuar;
- Çertifikatën që nuk është nën hetime;
- Deshmi mbi përvojën e punës prej 2 viteve ;
- Shkathtësi kompjuterike në aplikacione të programeve (Word, Excel ,AutoCAD ).
- ❖ *Aplikacionet mund të merrenë në zyrën Burimeve Njerëzore te KRU "Hidrodrini" Sh. A. Rr" Lekë Dukagjini" Nr.156 Pejë dhe Web –faqen " Hidrodrini" Sh. A. [www.hidrodrini.com](http://www.hidrodrini.com) .*
- ❖ *Aplikacionit i bashkangjiten kopje të dokumentacionit mbi kualifikimin, për përvojën e punës, dokumente tjera të nevojshme që kërkon vendi i punës për të cilën konkurrojnë kandidatët.*
- ❖ *Aplikacioni dhe dokumentet përcjellëse dorëzohen në KRU " Hidrodrini" Sh. A. Zyra e Burimeve Njerëzore në pliko të mbyllur në adresën: Rr. " Lekë Dukagjini" nr.156 – Pejë*
- ❖ *Shpallja do të jetë e hapur 15(pesëmbëdhjetë) ditë nga dita e publikimit nga data 12.07.2023 deri me 26.07.2023 në shtypin ditore dhe Web –faqen [www.hidrodrini.com](http://www.hidrodrini.com) .*
- ❖ *Kandidatët që ftohen në intervistë janë të obliguar të sjellin me vete dokumentet origjinale përverifikim para komisionit intervistues.*
- ❖ *Kandidatët që hyjnë në përzgjedhje të ngushtë, do të informohen lidhur me intervistën përmes telefonit ose me shkrim në afat ligjor nga zyra e Burimeve Njerëzore.*
- ❖ *Aplikacionet e dërguara pas afatit të cekur më lartë nuk do të pranohen. Dokumentat jo të kompletuara do të refuzohen, KRU " Hidrodrini" Sh. A. ofron mundësi të barabarta të punësimit për të gjithë shtetasit e Republikës së Kosovës.*